

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË “CHRILUK” SHPK

Sot në datën 15 Maj 2021 në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë “CHRILUK” SHPK themeluese e përcaktuar si më poshtë:

Znj. Albina HAXHIA, e bija e Hysenit dhe Valentines, lindur me 27/01/1975, ne Levan Fier dhe banuese në TIRANË, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me Nr, letërnjoftimi 032197277 dhe Nr. Personal H55127041M.

Neni 1

Dispoziat e përgjithshme

Shoqëria “CHRILUK” SHPK bazohet në legjislacionin shqiptar që rregullon pozitën juridike të subjekteve të tilla.

Me këtë statut rregullohen këto çështje:

- emertimi i shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve,
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret dhe
- marrëdhëniet juridike ndërmjet themeluesve të Shoqërisë, të drejtat e detyrimet e tyre, aksesin e të tretëve pranë kësaj zyre dhe menyrën e aplikimit të tyre për partneritet, llojin e partneritetit, rekrutimin apo punësimin e të asociuarve, menyrën e bashkëpunimit me subjekte të tjera provatë apo shtretërorë, kohëzgjatjen e veprimtarisë kritorete karrierës brenda Zyrës nga të interesuarit etj,

Neni 2

Emri,vula dhe selia e Shoqërisë

2.1 Shoqëria është person juridik privat dhe vepron si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ajo do të paraqitet në qarkullim me emrin Shoqëria “CHRILUK” SHPK.

2.2 Vendndodhja e shoqërisë është në TIRANË , në adresën Rruga Muhamet Gjollësja, Zona kadastrale Nr. 8250 , Pll .73, kt .1, ap 25 me sipërfaqe 48.9m2 Shqipëri.

Neni 3
VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si objekt kryesor të aktivitetit të saj veprimet e mëposhtme:

- 1) Exchange
- 2) Dhenie makina me qera
- 3) E Tjere

NENI 4
REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

4.1. Shoqëria ka karakteristikat e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj bazohet kryesisht në këtë Statut dhe në Aktin e Themelimit, në dispozitat e ligjit Nr. 9901, data 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4.2 Shoqëria bazohet mbi parimet e ekonomisë së tregut. Ajo ka për qëllim që të sigurojë shërbim cilësor për klientat e saj, si dhe të realizojë fitim nga ky aktivitet.

4.3 Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit perkates në përputhje me ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

4.4 Në përputhje me parashikimet ligjore mbi të cilat mbështet veprimtarinë dhe rregullat e vendosura në këtë statut, Shoqëria mund të ndryshojë strukturën apo regjimin juridik të saj.

Neni 5
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT THEMELUES

5.1 Ortaku administron aktivitetin e Shoqërisë në përputhje dhe konform objektit të saj. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e mire, administrohen edhe vlerat intelektuale dhe ekonomiko- financiare të Shoqërisë.

5.2 Ortaku ka dijeni në çdo kohë për gjendjen dhe rezultatin ekonomiko-financier të Shoqërisë dhe zotëron në do kohë të gjithë dokumentacionin me interns të saj.

5.3 Ai ruan të drejtën që në çdo kohë të tërhiqet nga pjesëmarrja në Shoqëri dhe të tjetërsojë pjesën e tij të kapitalit të investuar, në përputhje me rregullat e këtij statuti dhe ligjin perkatës.

5.4 Heqja doë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet që ka deri në çastin e heqjes dorë dhe, nuk e ndalon atë në marrjen e të ardhurave përkatëse të siguruar nga shoqëria deri në atë moment.

Neni 6
PASURITË E SHOQËRISË



6.1 Pasurite e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetin e saj, janë në pronesi te ortakëve në perputhje me kapitalin themeltar të investuar prej tyre, apo me kontributin për cdo aktivitet të vecantë të ushtruar prej Zyrës.

6.2 Me miratim të Mbledhjes së: Ortakëve, (kur ajo është formuar), investimi i secilit ortak në pasurinë e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me një gjendje të re të krijuar gjatë aktivitetit.

6.3 Ortaku (ët) mbane përgjegjësi për humbjet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, deri në kufirin e kontributit të investuar.

Neni 7 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në një afat të pakufizuar në kohë. Në rast mbarimi të aktivitetit të saj, Shoqëria do të ndjekë të gjitha procedurat e ngjashme që aplikohen nga shoqëritë tregtare për mbylljen e aktivitetit të tyre.

Neni 8 Burimet financiare

8.1 Shoqëria krijon burimet e saj financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së saj sipas objektit të përcaktuar.

8.2 Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.

8.3 Veprimtaria ekonomike-financiare ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Neni 9 Kapitali dhe kuotat e Shoqërisë

9.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, i formuar dhe i nënshkruar në masën 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë Znj. Albina HAXHIA. Kapitali ndahet në kuota gjithsej 1 (një) Kuotë me vlerë nominale prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.

9.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë Znj. Albina HAXHIA, zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

9.3 Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

9.4. Për vërtetimin e pronësisë mbi kuotat e më mësipërmë, shoqëria tregtare mund të lëshojë në emër të personit apo të personave që zotërojnë kuota, një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

Neni 10 Pasuria e Shoqërisë



10.1 Pasuritë e Shoqërisë perbëhen nga sendet e kontribuar prej ortakut themelues Znj. Albina HAXHIA, dhe nuk janë përfshirë në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

10.2 Në çastin e aderimit te nje ortaku të ri në Shoqëri, vlera e pasurive të Shoqërisë do të konsiderohet si kontribut i ortakut themelues dhe në rast se me zhvillimin e aktivitetit do të krijohen pasuri të tjera, atëherë ato do të konsiderohen që janë në bashkëpronësi të ortakëve sipas vlerës së kapitalit që ata kanë investuar.

Neni 11

Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretët vetëm më kontartë me shkrim dhe me miratimin e Asamblesë së Oratkëve me shumicë të cilësuar.

Neni 12

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themelor mund të zmadhohet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve themelues në një mbledhje të veçantë të asamblesë së pergjithshme të ortakëve.

Neni 13

Fondi Rezervë

Shoqëria krijon fondin reserve për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve të krijuara nga veprimtaria e saj ekonomike.

Neni 14

Përdorimi i të ardhurave

14.1 Shoqëri mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë: mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide ta mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

14.2 E ardhura e krijuar nga aktiviteti i Shoqërisë, pasi zbriten shpenzimet e bera dhe amortizimi i mjeteve të përdorura për çfarëdolloj aktiviteti, pagesat per tatimet dhe taksat vendore, pagat apo shpërblimet për punën e të punësuarve, asistentëve dhe bashkëpunëtorëve te tjere, pagesat e bëra per rritjen e investimeve në aktivitetin e Shoqërisë, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me kontributin e tyre.



Neni 15

Pasqyrat Financiare

15.1 Të ardhurat dhe pasuria e Shoqërisë vlerësohet në monedhë të vendit, në përputhje me rezultatet e nxjerra nga ana e ekspertëve kontabël të caktuar për të realizuar përpilimin e pasqyrave financiare.

15.2 Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni tatimor. Forma e pasqyrës financiarë të Shoqërisë, përputhet me formën e miratuar nga ekspertët në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme

16.1 Organi kryesor i Shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve. Ajo është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të mbledhet kur Ortakët apo Administratorët e Shoqërisë e shohin të nevojshme të shqyrtojnë një çështje të posaçme.

16.2 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mund të shqyrtojë e vendosë për të gjitha çështjet, me përjashtim për ato që statuti ka përcaktuar ndryshe.

16.3 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mbledhet të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj. Administratori, në rastet kur thërret mbledhjen, ben njoftimin me shkrim, për secilin ortak.

16.4 Në mbledhje mbahet procesverbal nga një sekretar i caktuar nga administratori.

16.5 Vendimet e marra nga mbledhja arrihen me shuainicë të cilësuar të votave të anëtarëve. Nëse numri i votave është i barabartë, vendimet merren në bazë të peshës së kuotës që ka secili ortak votues në kuotat e kapitalit të shoqërisë. Vendimet nënshkruhen nga Ortakët e Shoqërisë, si dhe ruhen në arkivin e Zyrës. Vendimeve të marra, u nënshtrohen të gjithë ortakët dhe punonjësit e tjerë të Zyrës.

Neni 17

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

17.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave të përgjithshme tregtare të Shoqërisë;
- të modifikojë dhe ndryshojë Statutin e Shoqërisë;
- emelimin apo shkarkimin e administratorëve;
- të përcaktojë ekspertin kontabël të miratuar apo likuiduesit e Shoqërisë;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- të përfaqësojë Shoqërinë në Gjykatë si dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- të riorganizojë dhe prishë Shoqërinë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 18 **Kompetencat dhe kufizimet**

18.1 Në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë mund të shqyrtohen dhe vendosen për çështje si me poshtë:

- Miratimi i mbylljes së veprimtarisë së Shoqërisë;
- Miratimi i shtimit/pakësimit të numrit të Ortakëve të Shoqërisë;
- Miratimi i fillimit të procedurave për falimentimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
- Miratimin e shtimit të aktiviteteve në fushat të veprimtarive të tjerë dhe rregjistrimet përkatëse sipas ligjit Nr. 9901, data 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

18.2. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret vetëm nga Ortakë. Ajo ndjek, për aq sa përputhen, të njëjtat rregulla me Mbledhjen e Zakonshme.

Neni 19 **Ortakët e rinj**

19.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e ortakëve mund të lejojë mbi bazë unanimiteti pranimin e ortakëve të rinj.

19.2 Kriteret e pranimit të ortakëve të rinj përcaktohen rast pas rasti nga Ortakët Themelues, apo edhe Ortakët e bashkuar me vonë atyre. Për çdo rast vlerësohen cilësitë profesionale të kandidatit, fusha e veprimtarisë kryesore të tij, kontributi në mbarëvajtjen e punëve të deri atëhershme të Zyrës, reputacioni publik i tij dhe të tjerë kritere të vendosura nga Mbledhja e Ortakëve.

19.3 Në rast të shtimit të Ortakëve të rinj, rregullohen edhe marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre, kuotat dhe kontributi, të cilat pasqyrohen menjëherë në statut.

Neni 20 **Administratori**

20.1 Administratori i Shoqërisë do të kryhet nga administratori ose administratorët e Shoqërisë. Ata kanë të drejtat për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, përveç atyre të drejtave që Ligji apo ky statut kalon Ortakëve të tjerë të Shoqërisë.

20.2 Administratori/Administratorët përfaqësojnë zyrën në marrëdhënie me të tretët si dhe përpara Oragneve të administratës shtetërore apo ato gjyqësore.

20.3 Administratorët emërohen apo shkarkohen nga detyra e tyre me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve.

20.4 Administratorët mund të jenë përgjegjës civilisht për dëmet që mund të shkaktojnë gjatë kryerjes së detyrës.

20.5 Administratorët përgjigjen në mënyrë të barabartë përpara: Ortakëve për punën e tyre dhe u krijojnë atyre akses në çdo dokumentacion apo punë të Zyrës, kur kërkohet prej tyre.

20.6 Administrator i parë i Shoqërisë "CHRILUK", do të Znj. Albina HAXHIA, për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë riemërimi, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të këtij Statuti dhe Akti Themelimi.

20.7 Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblese së Përgjithëshme,

Neni 21

Kompetencat e Administratorit

21.1 Administratori ka këto kompetenca kryesore:

- të miratojë planin e veprimtarisë së Zyrës dhe të paraqesë atë për miratim në Mbledhjen e Ortakëve;
- të rekomandojë ndryshime në kapitalin themeltar;
- të rregullojë me akte detyruese raportet e punës brenda Zyrës;
- të përfaqësojë Zyrën në marrëdhënie me të tretët;
- të përcaktojë strukturën e organizimit të Zyrës dhe përpiqet për përzgjedhjen e pjestarëve të saj, jo ortakë;
- të organizojë manuale mbi kriteret e punësimit dhe testime profesionale për të gjithë kandidatit që kërkojnë të punojnë në Zyrë;
- të gjitha detyrat e tjera që i ngarkohen nga Mbledhja e Ortakëve.

Neni 22

Eksperti kontabël

22.1 Ortakët caktojnë ekspertin kontabël . Ai mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e të gjitha llogarive të Shoqërisë.

22.2 Detyra e ekspertit kryhet nga persona të autorizuar nga ligji për veprimtari të tilla.



Neni 23 Punësimi

23.1 Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nga kontrata individuale e punës, rregullat e këtij statuti dhe Kodi i Punes.

23.2 Administratori i Shoqërisë përcakton kritere për punësimin e të punësuarve në Zyren e Shoqërisë.

Neni 24 Kontrata Individuale e Punës

24.1 Kontrata individuale e punës duhet të rregullojë:

- Marrjen në pune dhe kushtet e saj;
- Llojin e punës që do të kryhet, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore dhe javore, pushimet, shpërblimin për kohën e punës (mujor), shpërblimin për kohën jashtë orarit të punës, festave, ditëve të pushimit;
- Rregulla mbi konfidencialitetin e punës;
- Përgjegjësitë e palëve për cënimin e kontratës së punës dhe rregullave të gjithë pranuarat të punësimit.

24.2 Të punësuarit mbajnë përgjegjësi civile kur ata, e veprimet e tyre, i shkaktojnë dëm pasuror Zyres.

MBYLLJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË. LIKUJDIMI

Neni 25

Veprimtaria e Shoqërisë mund të mbyllet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortaktëve.

Neni 26

Kur Asambleja e Ortakëve merr vendim për mbylljen e veprimtarisë, caktohet një likuidator. Në këto raste përkrah emrit të Zyrës, shënohen edhe fjalët “*në likuidim*”.
Me miratimin e likuidimit, Zyra i jep fund veprimtarisë.

Neni 27

Ortakët vendosin mbi rregullsinë e likuidimit, bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiduesit.

Kur jam kushtet e kërkuara nga Ligji përkatës, Gjykata mund të vendosë për mbylljen e likuidimit me kërkesë të cdo të interesuari.

Aktet e mbylljes depozitohen në QKB.

Neni 28

28.1 Ky Statut dhe Akt Themelimi hyn në fuqi ditën që e aprovon themeluesi i Shoqërisë.

28.2 Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

28.3 Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë statut do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

ORTAKU THEMELUES

ALBINA HAXHIA

